



Dalës / Nazari

Nr. 15/659  
Br.

Data 15.09.2022  
Datimi



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**

**DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM**

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

**RAPOT**

**(Për Draft -rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba në komunën e Obiliqit)**

Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim me datë 19.08.2022 ka mbajtur diskutimin publik për **“Draft-rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba në komunë e Obiliqit”** diskutimi është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal, nga ora 14:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent pjesëtarë të ekzekutivit komunal, qytetar, grupi për debate publike dhe zyrtar publik.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 27 qytetarë, prej tyre 15 gra dhe 12 burra.

Pas prezantimit të draft rregullores nga shefi i sektorit për ekonomi, duke i njoftuar qytetarët se çka përmban rregullorja, kemi pranua tri (3) kërkesa për informacione.

- Rifadije Paloja, faleminderit për prezantimin, e çmoj shumë punën tënde, më intereson se ne i kemi disa institucione kulturore, të cilat duhet t'i përfshijmë në rregulloren për tarifa. A duhet ti referohemi kësaj rregullore për të përcaktuar tarifat tona?
- ✓ Daut Mjeku, kjo është rregullore që të gjitha tarifat, ngarkesat e gjobat duhet të përfshihen në të, 70% të tarifave janë të ardhura nga organet qendrore. Tarifat duhet të vendosen nga politikat tona komunale.

- Lindita Bekteshi, ju përgëzoj për punën, desha të pyes se çka nënkuptojnë tarifat për martesë jashtë vendit të punës?
  - ✓ Daut Mjeku, kjo vlen për ofiqarin i cili i lidh martesat, janë tarifa që vlejné kur e fton ofiqarin për ta lidhur martesën jashtë orarit të punës.
- Zelushe Kelmendi, nuk kam koment se nuk kam pasur rast ta lexoj, në momentin që kam rast ta lexoj do të dërgoj komente.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 14:25.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq  
15.09.2022

Zyrtar përgjegjës për konsultime publike  
Festina Preniqi, Flaka Hashani



*F. Preniqi*      *Flaka Hashani*